

Shënim: ky manual është prodhuar nga organizata Feeding Albania dhe u shërben si informacion atyre që kanë apo dëshirojnë të kenë një kotec pulash për përdorim vetjak. Këto këshilla janë të vlefshme për ju por ato nuk zëvendësojnë në asnjë rast këshillat e veterinerit. Flisni me veterinerin tuaj për çdo ushqim apo medikament që u jepni pulave tuaja.

USHQYERJA E PULAVE

Manuali i parë mbi rritjen e pulave në ambiente personale dhe për konsum të vogël, dha një paraqitje të përgjithshme se çfarë duhet të kemi parasysh gjatë mbajtjes së pulave si shpend për prodhim personal. Manualët shtesë do të sjellin më shumë informacion mbi secilën temë si ushqimi, sëmundjet, siguria, pastërtia dhe higjiena, prodhimi i vezëve, etj.

Tema e këtij manuali është USHQIMI. Ai diskuton nevojat për ushqim sipas moshës së pulave si dhe mënyra të tjera për të gjetur ushqim për to.

Ata që mbajnë pula, e dinë mirë se shpenzimi më i madh për mbajtjen e pulave (dhe shpendëve përgjithësisht) është ushqimi. Në fakt, është një mendësi tepër e gabuar që shpesh u jepet pulave ‘ushqim’ aq i dobët sa vetëm i tillë nuk mund të quhet. Ushqimet e mykura, te prishura, me erë, pa vlera e të ndenjura janë tepër të dëmshëm për shëndetin e tyre si dhe për tonin. Le të kemi parasysh se atë që do të hajë pula, do të hamë edhe ne.

Prandaj, të ushqyerit mirë e pulave dhe sipas nevojave të tyre është jo vetëm i rëndësishëm në aspektin e sigurisë ushqimore, (të hamë ushqim të pastër dhe të dimë se veza që po hamë, vjen nga një pulë e shëndetshme), por gjithashtu edhe sasia e prodhimit të vezëve është e lidhur drejtpërdrejtë me sasinë dhe cilësinë e ushqimit të pulave.

Ushqimi i pulave mban rolin kryesor në cilësinë e vezës që hamë. Kuptohet se të tjerë faktorë janë gjithashtu të rëndësishëm, si psh temperatura, pastërtia, etj. Por, një dietë e kontrolluar, cilësore është e nevojshme më së pari me qëllim që pula të marrë ushqyesit makro e mikro të nevojshëm në dietën e saj. Le të shikojmë specifikisht nevojat e pulave për ushqim.

Nevojat për ushqim sipas moshës

Së pari, të dimë se pulat konsumojnë rreth 180-250 gr ushqim në ditë. Ushqimi bazë duhet të zerë 90% të ushqimit që konsumon pula. 10%, por jo më shumë mund të jetë ushqimi shtesë, si psh krimbat e tokës apo të

tjera insekte që kemi mbledhur për to të cilat ato i hanë shumë. Në një farë mënyre, ushqimin suplementar mund ta paralelizojmë me atë ushqim që ne do të konsideronim ushqim ‘për qejf’ për ne njerëzit. Psh, pijet me gaz, çokollatat, biskota, fast food nuk mund të jenë me tepri në dietën tonë. Kështu edhe për pulat, ‘treats’ apo ushqimet shtesë, nuk mund të përbëjnë më shumë se 10% të ushqimit që u jepet.

Zogjtë e vegjël kanë nevojë për ushqim të pasur me proteinë në mënyrë që të rriten të shëndetshëm dhe të shtojnë peshë në kohë. 3 javët e para të jetës, zogu duhet të ketë një përqindje proteine rreth 22%. Midis javëve 3-8 të jetës, zogu duhet të ketë përqindje rreth 19-20%. Pas javës së 8 e deri në javën e 18, përqindja mund të ulet në 16-17% ose edhe 16% në rast se pulat kanë hapësirë të jashtme ku mund të gjejnë vetë krimba e insekte të tjerë.

Uji

Ushqimi i mirë fillon nga uji i pastër dhe i përhershëm. Shpendët i kanë kockat e lehta dhe konsumojnë sasi të madhe uji. Nëse ato nuk kanë ujë mjaftueshëm, ato do të stresohen, mund të sëmuren dhe do të ulin menjëherë prodhimin e vezëve. Për këtë arsye, uji është mirë të ndërrohet së paku një herë në ditë. Gjithashtu, mbajtëset e mbyllura të ujit ose ujitësit me pika uji janë mënyra shumë të mira që nuk lejojnë ndotjen e ujit të pijshëm. Pastrojini mbajtëset e ujit çdo javë me qëllim që të mos zënë myshk. U jepni pulave tuaja ujë të pastër çdo ditë.

Kalciumi shtesë

Pulat zakonisht mbahen për vezë ose për mish. Pulat e mishit nuk kanë nevojë për suplement kalciumi shtesë, pasi ato nuk do të prodhojnë vezë. Qëllimi i mbajtjes së tyre është që brenda dy muajsh ato të therren për mish; si të tilla, pulat e mishit duhet të ushqehen me një dietë të pasur në proteina për të mbështetur zhvillimin e shpejtë fizik të tyre.

Nga ana tjetër, pula e vezës mbahet për prodhim vezësh i cili fillon jo më herët se muaji i 6-të i jetës së pulës dhe vijon mesatarisht deri sa pula të jetë 3-4 vjeç. Më pas, cikli i prodhimit të vezëve të pulës përfundon. Pulat e vezës kanë nevojë për shtesë kalciumi në mënyrë që të formojnë lëvozhgën e vezës. Vlerësohet se gjatë jetës së saj, pula depoziton me anë të lëvozhgës së vezës së saj, rreth 50 herë masën e kalciomit në trupin e saj. Për shkak se 95% e lëvozhgës është kalciom dhe ushqimi i zakonshëm nuk ka mjaft kalciom për këtë qëllim, pula ka nevojë për suplement kalciumi i cili mund të sigurohet në mënyra të ndryshme. Mund të blihet, mund të sigurohet nga lëvozhgat e vezëve të mëparshme, ose nga guaskat e detit të thërmuara.

Të tjera

*Pulat të cilat kanë akses në diell, janë shumë më të shëndetshme se ato që jetojnë në ambiente të mbyllur. Rrjedhimisht, edhe veza e tyre do të jetë më e shëndetshme.

*Pulat që kanë hapësirë rriten shumë më të shëndetshme, me muskuj më të fortë dhe me sistem tretje më të gjatë e të fortë. Këto pula janë ato që i quajmë rracë fshati dhe që i preferojmë. Të tilla pula, janë njëkohësisht edhe më të forta për të përballuar sëmundjet, temë që do e prekim në manualin e rradhës.

*Mos harroni se pulat kanë nevojë të gëlltisnin zhavorr dhe guralecë të vegjël për të tretur ushqimin. Ato nuk kanë dhëmbë për të bluar ushqimin dhe i përdorin guralecët për ta bluar ushqimin në stomak, pak a shumë si parimi i mullirit që bluan drithin. Nëse pulat kanë akses në tokë të hapur, ato i hanë vetë guralecët. Por nëse i mbani mbyllur, sigurohuni që u lini vazhdimisht zhavorr në kotec dhe ato do të marrin aq sa kanë nevojë.

Përgatitja e ushqimit cilësor

Mënyra më e lehtë për të ushqyer pulat është duke e blerë ushqimin e tyre. Por, ushqimi i blerë jo vetëm që është i shtrenjtë, por shpesh edhe mund të mos jetë cilësor. Sa herë që blini ushqim, shikoni me kujdes datën e prodhimit dhe merrni ushqim sa më të freskët.

Çdo dietë ushqimi e pulave duhet natyrshëm të përmbajë karbohidrate, yndyrë, proteinë, vitamina dhe minerale. Për ta përgatitur vetë miksin e ushqimit, ju mund të përzieni sojë, grurë, misër, bizele dhe thekër.

Masat e miksit duhet të kenë përafërsisht raportet: 30-35% misër, 30-35% bizele, 25-30% grurë dhe rreth 5% elb ose tërshërë. Këtyre mund t'u shtohet pakëz kripë dhe pak fara luledielli në rast se është mundësia. Por gjithmonë të mbahet parasysh se 80% e ushqimit të një pule duhet të jetë drith. Të vihet re se shtesat në ushqim përveç sa më sipër përherë janë ndihmë për të furnizuar trupin e tyre gjithmonë të uritur. Por vini re se vetëm zogjtë e vegjël kanë nevojë të kenë ushqimin aty afër gjatë gjithë kohës. Pas javës së 6 të jetës, zogjtë mund të ushqehen dy-tre herë në ditë dhe të lihen të kërkojnë në oborr apo kopësht ushqimin shtesë.

Për t'u patur parasysh është fakti se se pulat e mishit kanë kërkesë më të lartë për proteinë. Prandaj dieta e tyre duhet të bazohet në misër. Sigurohuni që në vaktin e darkës së pulave, të përfshini gjithmonë misër, për t'i mbajtur gjatë natës. Ndërkohë pulat e vezës kanë nevojë relativisht për më pak proteinë. Në çdo rast, flisni me veterinerin tuaj për kërkesat specifike për ushqim të pulave tuaja.

Disa metoda alternative për uljen e kostove në ushqim

Disa mënyra se ku mund të gjendet ushqim falas ose me kosto minimale për pulat tuaja janë më poshtë.

Mënyra e parë ka më shumë sukses në zona urbane ku ka më tepër popullatë. Për pulat e kotecit tuaj, ju mund të flisni me restorante të zonës për të marrë mbetjet e shumta ushqimore që ata kanë. Gjelltoret, restorantet, pikat e shitjes së fruta-perimeve do të ishin të gatshme t'ua jepnin tepricat e tyre që nuk kanë shitur. Kuptohet që duhet të shikohet me kujdes ushqimi i dhuruar që u hidhet pulave dhe të hiqen paraprakisht pjesë të kalbura e të mykura.

Një mënyrë e provuar sidomos në ferma të mëdha, është që në mëngjes, kur i hapim pulat, të mos u japim menjëherë vaktin e parë, por t'i lëmë të lira ta kërkojnë ushqimin vetë nëpër oborr, krimba, bar, etj, dhe, më vonë, rreth orës 11 am, t'u japim vaktin e parë. Kjo mënyrë mund të ulë deri në 25% shpenzimet për ushqim.

Gjatë muajve të ftohtë të dimrit, sidomos në zonat e ftohta, bari dhe bimët thahen dhe nuk ka shumë ushqim të freskët. Në këtë kohë, për të ndihmuar me ushqim të freskët, mund të përdoim metodën e mbirjes së farave. Psh, mund të mbushim 1/3 e një kove me grurë apo misër dhe 2/3 e saj me ujë. E mbulojmë dhe e mbajmë brenda në një vend jo të ftohtë. Pas 2-3 ditësh, gruri do të ketë mbirë dhe filizat sigurojnë një ushqim të freskët me ujë dhe me vitamina të shtuara. Dihet se filizat kanë më shumë vlera ushqimi se farat e bimëve si edhe bimët e rritura. Kjo është një metodë e lehtë por shumë efektive për të siguruar variacion për shpendët tuaj.